

## **KONTRATË DHURIMI KUOTASH TË SHOQËRISË “ ATRIUM” SHPK**

Sot më date 05.07.2021 në Tiranë, nënshkruhet kjo kontratë dhurimi kuotash mes palëve kontraktuese si vijon :

### *Pala DHURUESE*

Z.Klajdi Shanaj, lindur në Tiranë, i datëlindjes 17.10.1988 , shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr personal I81017047D, që më poshtë në këtë kontratë do të referohet si palë dhuruese.

### *Pala PRANUESE*

Znj.Enejda Shanaj, lindur në Tiranë, e datëlindjes 13.09.1988 , shtetase Shqiptare, madhore dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtësee dokumentit të identifikimit me nr personal I85913058K, që më poshtë në këtë kontratë do të referohet si palë përfituese.

të cilët shprehën vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë për të përpiluar dhe nënshkruar kontratën e trabsferimit apo dhurimit të kuotave të kapitalit themeltar, si më poshtë :

### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Pala dhuruese është ortak i vetëm i shoqërisë “Atrium” SHPK regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit datë 28.06.2018 me numër unik identifikimi L81828011Q me ortak si më poshtë;

-Klajdi Shanaj, zotërues i 100% të kuotave të kapitalit të përbërë nga 1 kuotë e vetme në vlerën nominale 100 lekë gjithsej.

### **OBJEKTI I KONTRATËS**

Pala dhuruese, z. Klajdi Shanaj , i dhuron me vullnet të lirë e të plotë palës pranuese 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me vlerën 100lekë, që zotëron në shoqërinë “Atrium” SHPK

Pala pranuese , Znj.Enejda Shanaj, me vullnet të lirë e të plot, i pranon palës dhuruese z.Klajdi Shanaj 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë të përbërë nga 1 kuotë e vetme në vlerën nominale 100 lekë gjithsej.

## **TRANSFERIMI I PRONËSISË**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, pala dhuruese zhvishet nga 100% e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe pala pranuese bëhet zotëruese e 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pas nënshkimit të kontratës ortak i vetëm i shoqërisë është pala përfituese (pranuese) znj. Enejda Shanaj, zotëruese tashmë 100% të kuotave të kapitalit, shoqërisë të përbërë nga 1 kuotë e vetme në vlerën nominale 100lekë gjithsej.

Pala pranuese merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë që nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Pala pranuese nuk ka asnjë përgjegjësi për detyrimet që pala dhuruese mund të ketë jashtë shoqërisë.

## **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Kontrata u përpiluar në 3 kopje me fuqi të barabartë, njëra prej të cilave depozitohet në regjistrin tregtar duke u bërë shënimet për ndryshimet përkatëse.

## **PALËT KONTRAKTUESE**

### **PALA DHURUESE**

**Z. Klajdi Shanaj**

*Klajdi Shanaj*  


### **PALA PRANUESE**

**Znj. Enejda Shanaj**

*Enejda Shanaj*  
